



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika “c” dhe nenit 17 pika “n” të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 40 të Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme, dispozitave të nenit 41, paragrafi 2, pika “c” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, miratoi këtë:

**RREGULLORE**  
**(KKV) NR.01/2020 PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË**  
**VEPRIMTARIVE AFARISTE - BIZNESEVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për veprimtaritë tregtare dhe veprimtaritë tjera: prodhuese, shërbyese, hoteleri, ndërtimtari, zejтари dhe të tjera, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Veprimtaritë afariste - bizneset në pajtim me nenin 1 të kësaj rregulloreje janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë rregullore.

**Neni 3**  
**Orari i punës**

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.
2. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit, në të cilin kryhet veprimtaria afariste - biznesi dhe duhet saktësuar fillimi dhe mbarimi i orarit të punës dhe ditët që nuk punohet.
3. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në këto intervale kohore:
  - 3.1. Periudha verore fillon më 1.4 dhe zgjat deri më 30.9, të vitit kalendarik;
  - 3.2. Periudha dimërore fillon më 1.10 dhe zgjat deri më 31.3, të vitit kalendarik.

#### **Neni 4**

### **Orari i punës për dyqane zejtare, autolarje, floktore, sallon ondulimi dhe veprimtari të ngjashme**

1. Orari i punës fillon dhe mbaron:

- a) Periudha verore prej orës 07:00 – 22:00;
- b) Periudha dimërore prej orës 08:00 – 20:00.

2. Gjellëtoret dhe qebaptoret do të punojnë çdo ditë pune:

- a) Në periudhën verore prej orës 06:00 – 23:00;
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 22:00.

3. Ditën e vikendit (e diel) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç: gjellëtoreve, qebaptoreve, restoranteve dhe kafiterive.

4. Përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, veprimtaritë afariste të lartpërmendura brenda çdo muaji duhet të kenë një (1) ditë pushim, ndërsa sallonet e ondulimit e kanë pushim çdo të diel.

#### **Neni 5**

### **Orari i punës për supermarkete, vetëshërbime, dhe dyqane ushqimore**

1. Orari i punës fillon dhe mbaron:

- a) Në periudhën verore prej orës 07:00 – 23:00;
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 22:00.

2. Orari i punës i dyqaneve tregtare të tekstilit, dyqaneve të këpucëve, teknikës së bardhë dhe veprimtarive të tjera ushqimore do të jetë:

- a) Periudha verore prej orës 07:00 – 21:00;
- b) Periudha dimërore prej orës 08:00 – 20:00.

3. Ditën e vikendit (e diel) veprimtaritë afariste - bizneset e përmendura në këtë nen nuk do të punojnë.

#### **Neni 6**

### **Orari i punës për depo të artikujve ushqimorë, depo të materialit ndërtimor dhe ndërmarrjeve të cilat merren me prodhimin e betonit**

1. Orari i punës fillon dhe mbaron:

- a) Në periudhën verore prej orës 08:00 – 20:00;
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

2. Orari i punës për ndërmarrjet ndërtimore (ndërtim i ulët dhe i lartë) do të jetë:

- a) Në periudhën verore prej orës 07:00 – 18:00;
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

3. Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare bizneset e përmendura në këtë nen nuk do të punojnë.

### **Neni 7**

#### **Orari i punës për kafene, hotele, motele dhe restorante**

1. Orari i punës do të jetë:

- a) Në periudhën verore prej orës 07:00 – 24:00;
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 23:00.

2. Orari i punës në hotele, motele dhe restorante është i njëjtë në të dy sezonat dhe fillon prej orës 07:00 – 24:00.

3. Përrjashtimisht nga pika 2 e këtij neni, mund të punojnë më gjatë se orari i punës, por jo më shumë se ora 03:00 e mëngjesit.

4. Situatat nga paragrafi 3 i këtij neni realizohen duke kërkuar leje të veçantë (24 orë më herët), të cilën e lëshon Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, njëzet (20.00) € për orë.

6. Veprimtaritë afariste – bizneset që organizojnë muzikë live, pas pajisjes me leje të veçantë, për veprimtari pas orarit të punës, duhet të paguajnë shumën prej 50.00 € për orë, por jo më gjatë se në ora 03:00 të mëngjesit.

### **Neni 8**

#### **Orari i punës për aktivitete sportive dhe rekreative**

Stadiumet e improvizuara të futbollit, palestrat sportive, objektet tjera sportive dhe rekreative punojnë deri në orën 24:00.

### **Neni 9**

#### **Ruajtja e qetësisë publike gjatë aktiviteteve sportive dhe rekreative**

Veprimtaritë e parapara në nenet 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, gjatë orarit të punës nuk duhet t'ua prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të tyre.

**Neni 10**  
**Orari i punës për qendrat e thirrjeve “Call Center”**

Bizneset që ushtrojnë veprimtari “Call Center” dhe veprimtari të ngjashme, orari i punës do të përshtatet me orarin e punës sipas orës së shteteve, të cilat kanë tjetër matje kohore.

**Neni 11**  
**Orari i punës për tregje**

1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve do të jetë:

- a) Në periudhën verore prej orës 06:00 – 19:00;
- b) Në periudhën dimërore prej orës 07:00 – 18:00.

2. Tregu i gjelbër është i hapur ditëve të javës, përveç të dielave dhe ditëve të festave shtetërore.

3. Tregu i kafshëve punon vetëm ditën e premte, prej orës 06:00 – 14:00.

**Neni 12**  
**Kufizimet kohore specifike për programe muzikore**

Në objektet hoteliere, të cilat gjenden në afërsi prej 100 m nga objektet e banimit, e në të cilat organizohet program muzikor apo me audio-video, mjete për reproduktimin e programit, nuk mund të mbahet pas orës 24:00.

**Neni 13**  
**Orari i punës për pikat e shitjes së karburanteve**

Orari i punës për pikat e shitjes së karburanteve, është i njëjtë për të dy sezonat dhe fillon prej orës 00:00 e zgjat deri në ora 24:00 (pa ndërprerë).

**Neni 14**  
**Orari i punës për barnatore, ordianca dhe klinika private**

1. Orari i punës për barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë i njëjtë për të dy sezonat dhe fillon prej orës 07:00, ndërsa mbaron në orën 22:00.

2. Barnatoret që veprojnë në qytet në afërsi të shërbimeve mjekësore në harmoni me planin për kujdestari, të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural do të kujdestarojnë 24:00 orë (pa ndërprerë).

**Neni 15**  
**Gjobat**

Të gjitha veprimtaritë afariste - bizneset do të gjobiten për kundërvajtje nga 300.00 – 1,000.00 €, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

**Neni 16**  
**Mospërfillja e kodit afarist**

Veprimtaritë afariste – bizneset, të cilat marrin leje për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afarist dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve, do t'u merret leja e punës, e lëshuar nga Drejtoria e Ekonomisë, Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Neni 17**  
**Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje**


Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset: Drejtoria për Inspektime, Drejtoria për Ekonomi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Policia e Kosovës, Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje.

**Neni 18**  
**Harmonizimi i orarit të punës për të gjitha veprimtaritë afariste**

Të gjitha veprimtaritë afariste - bizneset, janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregulloreje, në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja 01 Nr.272/10 e datës 30.12.2010 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**  
  
**Kryesues i Kuvendit**

